



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 16.09.2024)

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:15 dhe mbaroi në orën 11:20.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| <i>1. Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>2. Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>3. Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>4. Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>6. Bledar Bajri</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Albens Tabaku</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>8. Markelian Koça</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>9. Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Emona Muçi*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve*

me Jashë.

3. Etrita Petriti, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative.

4. Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.

5. Maela Alicanaj, Dorina Prifti, Gentiana Agushi dhe Rezarta Taushani, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

6. Denisa Varfi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.

7. Staf nga administrata e KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e zgjedhjes së tetë anëtarëve të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor”.

Ilir Rusi: Përshëndetje anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor!

Sipas njoftimit të bërë dhe për shkak të krijimit të kuorumit të nevojshëm, deklaroj të hapur mbledhjen e ditës së sotme, datë 16.09.2024, në lidhje me shqyrtimin e projektvendimit “Për miratimin e zgjedhjes së tetë anëtarëve të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor”.

Për arsye objektive Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor nuk mund të jetë prezent në mbledhje dhe mbledhja do të drejtohet nga ana ime si Zëvendëskryetar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Gjithashtu edhe anëtare zonja Emona Muçi, për arsye shëndetësore, nuk mund të jetë prezent në mbledhje.

Për shkak edhe të krijimit të kuorumit të nevojshëm mbledhjen e deklaroj të hapur, për më tej fjalën relatores, Drejtoreshës znj. Petriti.

Etrita Petriti: Të nderuar, faleminderit!

Këshilli i Lartë Gjyqësor në mbledhjen e datës 13.09.2024, me vendimin nr. 500 ka miratuar listën përfundimtare të gjyqtareve të cilët do të merrnin pjesë në hedhjen e shortit për përzgjedhjen e tetë anëtarëve të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor (listë e përbërë me 95 emra të gjyqtarëve magjistratë).

Ditën e sotme, në datën 16.09.2024 në përfundim të hedhjes së shortit u zgjedhën 8 anëtarët e Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor si më poshtë:

1. Znj. {...};
2. Znj. {...};
3. Znj. {...};
4. Znj. {...};
5. Z. {...};
6. Z. {...};
7. Z. {...};
8. Znj. {...}

Referuar pikës 3, të nenit 146 të Kodit Zgjedhor, për zgjedhjen e anëtarëve të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, rezulton se pas organizimit të shortit, Këshilli i Lartë Gjyqësor, brenda 24 orëve nga hedhja e tij duhet të miratojë me vendim zgjedhjen e tetë gjyqtarëve si anëtarë të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor. Anëtarët e Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor do të delegohen në këtë detyrë me një mandat 4-vjeçar.

Për këtë arsye, propozojmë projektvendimin si më poshtë:

1. Të miratohet zgjedhja e tetë anëtarëve të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, si më poshtë:

1. Znj. {...};
2. Znj. {...};
3. Znj. {...};
4. Znj. {...};
5. Z. {...};
6. Z. {...};
7. Z. {...};
8. Znj. {...}.

2. Anëtarët e Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor delegohet në këtë detyrë me një mandatit 4-vjeçar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

Meqenëse nuk ka diskutime, kalojmë në miratimin e projektvendimit përkatës.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Pro.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për miratimin e zgjedhjes së tetë anëtarëve të Kolegjit Zgjedhor Gjqësor”.

Këshilli i Lartë Gjqësor, bazuar në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Të miratojë zgjedhjen e tetë anëtarëve të Kolegjit Zgjedhor Gjqësor, si më poshtë:

1. Znj. {...};
2. Znj. {...};
3. Znj. {...};
4. Znj. {...};
5. Z. {...};
6. Z. {...};
7. Z. {...};
8. Znj. {...}.

2. Anëtarët e Kolegjit Zgjedhor Gjqësor delegohet në këtë detyrë me një mandatit 4-vjeçar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjqësor.

Ilir Rusi: Në vijim, sipas përcaktimeve ligjore, gjyqtarët e Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor do të bëjnë betimin në një ceremoni publike, e cila do të zhvillohet ditën e nesërme, datë 17 shtator 2024, ditë e martë, ora 10:00, në ambientet e Polit të Drejtësisë.

Ftoj administratën të njoftojë në mënyrë individuale, me postë elektronike dhe me telefon, gjyqtarët e zgjedhur anëtarë të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor. Gjithashtu të njoftojë edhe përfaqësues të publikut, mediat, përfaqësues të subjekteve politike, Kolegjit Zgjedhor, përfaqësues të Shoqërisë Civile dhe përfaqësues të tjerë të cilët kanë dëshirë të marrin pjesë në këtë ceremoni publike të betimit të gjyqtarëve si anëtarë të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor.

Me shqyrtimin dhe miratimin e kësaj pike, mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor